# DËSHMI ARKIVI

**A-457293**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Jep dorëheqjen drejtori i Muzeut të Gjirokastrës pas skandalit me portretin e Çerçiz Topullit |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/reagimet-pas-ekspozimit-te-rrobave-te-erciz-topullit-jep-doreheqjen-k-i104976` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 10:06:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 10:04:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `10832d1a7640093de0fd8c6ae275dc1f8d123505943ab873c235ca8c2ee49329` |
| TEKSTI | `461084a96beda2894a0ab5e98ab4d637644344d63154125fb4ba98c35c3a42ba` |
| PAMJA | `8f0f8224b8625fce402b9dffcf9bd70047b0295b77522fe2685063245d92cde9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `58766cdf4d78e99814b7b3b6a903d17b8a895240ae648ed9d5cee7339530a72d` |
| E MËPARSHMJA | `fb4299c5860934ec0e8db947d1a24e65f1d9be03349fa646e0e3a2e54ac77a3e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/58766cdf4d78e99814b7b3b6a903d17b8a895240ae648ed9d5cee7339530a72d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Jep dorëheqjen drejtori i Muzeut të Gjirokastrës pas skandalit me portretin e Çerçiz Topullit

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 12:04



Kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore, Florian Hysi, ka dhënë dorëheqjen nga detyra, pas reagimeve të shkaktuara nga mënyra e ekspozimit të veshjeve të Çerçiz Topullit në Muzeun Historik, në kalanë e Gjirokastrës.

Sipas informacionit të bërë publik, në qendër të reagimeve ishte mënyra e paraqitjes së manekinit ku ishin vendosur rrobat e figurës historike. Ekspozimi është konsideruar i papërshtatshëm dhe jo në përputhje me mënyrën e konceptimit të ekspozitës.

Pas reagimeve, Hysi i ka paraqitur dorëheqjen kryebashkiakut të Gjirokastrës, Flamur Golemi.

Në deklaratën e tij, Hysi thotë se e merr vendimin me përgjegjësi dhe pranon përgjegjësinë për gabimin, duke theksuar se ai është korrigjuar.

*"E bëj këtë vendim me përgjegjësi dhe me bindjen se çdo detyrë publike duhet të shoqërohet me përgjegjësi personale për çdo vendim, veprim apo gabim që mund të ndodhë gjatë saj. Ajo që u konsiderua gabim u korrigjua dhe marr të gjithë përgjegjësinë përsipër"*, shkruan Hysi.

Ai ka falënderuar Bashkinë e Gjirokastrës, kryebashkiakun Golemi, kolegët dhe veçanërisht punonjësit e Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore për mbështetjen gjatë periudhës së tij në krye të institucionit.

"Dorëheqja ime nuk është dorëzim nga ajo që besoj. Është një akt përgjegjësie dhe respekti për institucionin!", shprehet Hysi.

Ai shton se do të vijojë të mbështesë Gjirokastrën, trashëgiminë kulturore dhe kujtesën kombëtare, ndërsa e mbyll deklaratën me mesazhin: "Ne u përpoqëm, atë që u konsiderua gabim e korrigjuam dhe punën do ta lëmë të flasë vetë."

*Pas një periudhe pune të përkushtuar në shërbim të trashëgimisë kulturore, muzeve dhe Gjirokastrës, kam vendosur të jap dorëheqjen time prej pozicionit që mbaj.*
*E bëj këtë vendim me përgjegjësi dhe me bindjen se çdo detyrë publike duhet të shoqërohet me përgjegjësi personale për çdo vendim veprim apo gabim që mund të ndodhë gjatë saj. Ajo që u konsiderua gabim u korrigjua dhe marr të gjithë përgjegjësinë përsipër.*
*Largohem me mirënjohje për mbështetjen e Bashkisë Gjirokastër për kolegët dhe veçanërisht për punonjësit e Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore me të cilët kemi punuar dhe realizuar ehumë më shumë më tepër sesa ishte bërë prej vitesh.*
*Dorëheqja ime nuk është dorëzim nga ajo që besoj. Është një akt përgjegjësie dhe respekti për institucionin !*
*Mbetem mirënjohës për punën e bërë, për përpjekjet tona dhe për çdo gjurmë që kemi lënë në muze dhe në kujtesën e Gjirokastrës.*
*Do të vazhdoj ta dua dhe ta mbështes Gjirokastrën, trashëgiminë e saj dhe kujtesën tonë kombëtare , në çdo formë që do të më jepet mundësia.*
*Ne u përpoqëm atë që u konsiderua gabim e korrigjuam dhe punën do t'a lëmë të flasë vetë.*
*Mirënjohje !*

*Florian Hysi*

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 19 Shtator12:02

**Plagosja në Tiranë, reagon policia: U qëllua ajër pas një konflikti çasti, autori në kërkim**

Një 45-vjeçar është shpallur në kërkim nga Policia e Tiranës, pasi dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në...

AKTUALITET 19 Shtator11:55

**Caktohet data/ Ja kur do të bëhet pritja diplomatike e ambasadorit të ri të SHBA, Eric Wendt**

Ambasada e SHBA në Tiranë ka shpërndarë ftesa për pritjen diplomatike të Ambasadorit Eric Wendt me datë 2 tetor. Gjeneral-...

AKTUALITET 19 Shtator11:44

**Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në Tiranë, një person i plagosur**

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 19 Shtator11:06

**Von der Leyen viziton Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi e Maqedoninë e Veriut, lë jashtë Serbinë dhe Bosnjën**

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, nuk do të vizitojë Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën gjatë turit të ...

AKTUALITET 19 Shtator11:00

**“Familjet marrin borxh për të mbyllur muajin”/ Tabaku: Paratë publike shkojnë te të privilegjuarit pranë qeverisë**

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, e lidhi rritjen e kostos së jetesës me korrupsionin dhe mënyrën si shpërndahen p...

AKTUALITET 19 Shtator10:57

**Çmimi i karburantit, Bordi i Transparencës merr vendimin, ja sa do të shitet nafta dhe benzina**

Bordi i Transparencës ka vendosur çmimet e reja për shitjen me pakicë dhe shumicë të naftës dhe benzinës, pas shpallje...

AKTUALITET 19 Shtator10:49

**Frikë nga shpopullimi apo epërsi për të treguar ‘muskujt’? Greqia jep deri në 10 mijë euro për ata që zhvendosen në zonat kufitare**

Greqia po zgjeron një program financiar për të nxitur banorët të zhvendosen në zona të largëta kufitare, siç ja...

AKTUALITET 19 Shtator10:45

**Falsifikuan dokumentet për 6 prona në Fier, arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi**

Ish-drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Fier, E.S., dhe shtetasi E.H., i dyshuar si përfitues i gjashtë pronave...

AKTUALITET 19 Shtator10:35

**Bashkëshortja e Alban Hoxhës ndërroi jetë pas lindjes së djalit/ Gjykata e Lartë lë në fuqi dënimin për Elona Burbën dhe Petrit Rexhepin**

Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit dhe la në fuqi dënimin për dy mjekët Elona Burba dhe Petrit Rexhepi, të cilët ...

AKTUALITET 19 Shtator09:53

**Sekuestrohen mbi 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali**

Policia italiane ka sekuestruar mbi 414 kilogramë hashash, me një vlerë prej mbi 4 milionë eurosh, ndërsa në pranga ka rën&...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

**"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...**

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...]

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

BOTA 18 Shtator

[Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...]

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

INVESTIGIME 18 Shtator22:42

[“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit]

Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në “mollë sherri” dhe ka ...

## video



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**"Dua 120 mijë euro"/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.